



NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë

Ndërmarrja **SONEL 888 LTD Branch in Kosovo** me adresë **Rr. Ali Vitia BII-Office, Administrata K.III/3/1, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës**, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të **Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë**. Aplikacioni për licencim të këtij aktiviteti me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike i ndërmarrjes **SONEL 888 LTD Branch in Kosovo** përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara
- blejë dhe shes kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit tjerë me çmime të parregulluara;
- shes kapacitete dhe energji elektrike furnizuesve tjerë me çmim të pa-rregulluar; dhe
- transitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Bekim Fehmiu", (ish Ndërtesa e Fazitës), Kati II, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

Rr. Ali Vitia BII-Office, Administrata K.III/3/1, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës